



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPSTINA VUCITRN

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e –IX-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më
15 tetor 2018 në sallën e komunës, e cila filloi në ora 14:15.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Fjolla Ujkani, Ymer Haradinaj, Rrezarta Krasniqi, Shkëlzen Feka, Melihate Basholli-Latifi dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Munguan: Shpëtim Zhegrova dhe Lutfi Bilalli.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Xhafer Tahiri (kryetar i komunës), drejtorët e drejtorive (Lutfi Gërguri, Afrim Namani, Adnan Lahu, Berat Sadiku), Ismet Gashi, nga zyra ligjore, Islam Latifi nga Drejtoria për Shërbime Publike, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ai deklaroi se në mënyrë elektronike, por edhe fizike kanë ardhur disa pika, i cili kërkoi që të futen në të ndryshme.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – theksoi se nga mediat jemi informuar që është paditur Komuna e Vushtrrisë lidhur me mosrespektimin e kriterit gjinor në KPF. Prandaj, kërkojmë një informatë nga ju si kryesues lidhur me këtë çështje.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF-së - tha se para disa seancave e kemi proceduar rishqyrtimin e vendimit të KPF-së për plotësimin e kriterit gjinor, por që ka munguar vullneti politik. Prandaj, para kuvendit e kemi kryer një obligim. Sipas tij, shumica e komunave nuk janë marrë me këtë çështje, por ne kemi qenë në MAPL dhe kemi zhvilluar takim për këtë. Në takim me ta, ne jemi zotuar se do ta dërgojmë çështjen në kuvend për rishqyrtim të vendimit. Në bazë të zhvillimeve që i kam parë, e shoh këtë çështje si politike.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – lidhur me këtë çështje njoftoi të pranishmit se Komuna e Prishtinës i ka 11 anëtarë, kurse i ka vetëm 3 femra. Në anën tjetër, Komuna e Suharekës i ka 7 anëtarë të KPF-së dhe të gjithë janë meshkuj. Ne si komunë e plotësojmë kriterin prej 30% ashtu qysh kërkohet me Ligjin e zgjedhjeve. Sipas tij, kriterin gjinor e plotësojnë vetëm dy komuna: Skënderaj edhe një komunë tjetër që nuk i kujtohet. Asnjë komunë në Kosovë, asnjë kuvend i komunës, as Kuvendi i Kosovës, as Qeveria e Kosovës nuk e plotëson kriterin gjinor prej 50%, ashtu qysh e kërkon Ligji për Barazi Gjinore. Ai theksoi se pse veç Komuna e Vushtrrisë të paditet. Ai tha se kjo çështje është politike, për shkak se një subjekt politik nuk e ka edhe një anëtar më shumë në KPF dhe se i kanë njerëzit e vet në qeveri. Prandaj, me dy standarde nuk duhet të punohet, qysh ka vepruar në këtë rast Ministria e Drejtësisë.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – tha se edhe unë i kam shikuar dy qytetet që i kemi afër: Prishtinën dhe Mitrovicën dhe se asnjëra prej tyre nuk e plotëson kriterin gjinor prej 50% që po kërkohet nga ne që ta respektojmë. Sipas tij, edhe në mandatin e kaluar ka qenë e njëjta gjë, por nuk jemi paditur. Prandaj, kjo është shqetësuese, sepse po krijohet një precedent i keq.

Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për”, aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 14.9.2018 dhe 24.9.2018;
2. Shqyrtimi i Planit i veprimit të menaxhmentit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëshuara në Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare për Auditim-Komuna e Vushtrisë;
3. Shqyrtimi i Raportit lidhur me aktivitetet për implementim të Planit lokal pesëvjeçar të menaxhimit të mbetjeve 2016-2020, si dhe gjendjen e pastërtisë në Komunën e Vushtrisë;
4. Shqyrtimi i Raportit lidhur me vizitat sistematike të nxënësve të klasave të para të SHFMU-së të Komunës së Vushtrisë;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore;
6.
 - a. Shqyrtimi i Raportit janar-shtator 2018 për të hyrat dhe shpenzimet;
 - b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpallje të ankandit publik;
 - c. Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019;
 - d. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim, KRM “Uniteti”, Sh.A. njësia në Vushtri.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa mbajtur më 14.9.2018 dhe 24.9.2018.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se i përcjell edhe procesverbalet e komunave tjera dhe se sa i përket hartimit të procesverbaleve të KPF-së, zyrtari është në nivel sa i përket drejtshkrimit. Ai tha se ka një vërejtje tek procesverbali i datës 24.9.2018, ku në faqen 3 të procesverbalit thuhet: “Por, do ta keni të vështirë të merreni “vesh” në mes veti, sepse jeni shumë parti politike në koalicion”. Në ç’ rast ai kërkoi që fjala “vesh” të hiqet nga thonjëzat, sepse nuk ka kuptim të metaforizmit, por e kam përdorur për shkak se po shihet se e keni vështirë të pajtoheni.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 14.9.2018.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi me ndryshime procesverbalin e datës 24.9.2018.

2. Shqyrtimi i Planit i veprimit të menaxhmentit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëshuara në Raportin e Auditimit të Zyrës Kombëtare për Auditim-Komuna e Vushtrisë.

Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së - tha se sektori përgjegjës në bashkëpunim me kryetarin e kanë hartuar këtë plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të

përgjithshëm. Ai tha se gjatë një punëtorie që isha, lidhur me prezentimin e raportit të auditimit, u tha se Komuna e Vushtrrisë gjendet në mesin e pesë (5) komunave që kanë bërë hapa të mirë në zbatimin e rekomandimeve të auditorit.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – deklaroi se kryetari i komunës duhet ta merr përsipër këtë çështje dhe së bashku me drejtorët e drejtorive të punojnë për zbatimin e rekomandimeve të auditorit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i Raportit lidhur me aktivitetet për implementim të Planit lokal pesëvjeçar të menaxhimit të mbetjeve 2016-2020, si dhe gjendjen e pastërtisë në Komunën e Vushtrrisë.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – deklaroi se një nga punët që mund të quhet sukses gjatë vitit 2018 është menaxhimi i mbeturinave. Nuk ka shtëpi dhe lagje në komunën tonë që nuk i shkon shërbimi i mbledhjes së mbeturinave. Ai falënderoi stafin e Drejtorisë për Shërbime Publike për punën dhe angazhimin e tyre në këtë projekt. Sipas tij, janë 2000 kontejnerë që janë blerë me mjete të buxhetit të komunës, si dhe do t'i blejmë edhe 2500 kontejnerë familjarë dhe do ta bëjmë shpërndarjen e tyre. Ai tha se jemi në rrugë të mirë për ta mbuluar territorin e komunës jashtë qytetit me kontejnerë familjarë dhe në këtë mënyrë ta krijojmë një ambient më të pastër.

Islam Latifi, përfaqësues nga Drejtoria për Shërbime Publike – theksoi se sa i përket pagesës për mbeturinat, çdo muaj po kemi ngritje të pagesave. Ai tha se në bashkëpunim me GIZ-in janë duke planifikuar që ta bëjnë trajnimin e zyrtarëve të kësaj fushe. Po ashtu, vlen të ceket se Vushtrria do të merret si model nga komunat tjera lidhur me menaxhimin e mbeturinave.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Raportit lidhur me vizitat sistematike të nxënësve të klasave të para të SHFMU-së të Komunës së Vushtrrisë.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – theksoi se është një punë e mirë që është bërë nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe nga ekipi që ka kryer vizitat sistematike. Megjithatë, janë disa çështje që janë shqetësuese sa i përket shëndetit të nxënësve si mbipesha, shikimi. etj. Ai kërkoi që këto çështje të ngritën në kuvend dhe të ketë një debat të mirëfilltë, pasi që bëhet fjalë për shëndetin e nxënësve. Në fund kërkoi që pas aprovimit në kuvend të këtij raporti të publikohet në web faqen e komunës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me rezultatet (ecurinë) e dhënies në shfrytëzim të tokave bujqësore.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – kërkoi që të krijohet edhe një shtyllë në tabelën e regjistrit të shfrytëzuesve të pronave komunale dhe të vendosen zonat kadastrale, si dhe tek vërejtja të ceken shfrytëzuesit e pronave që kanë borxhe. Tek kontrata e fundit po më duket që është një gabim teknik, prandaj ai kërkoi që të bëhen këto përmirësime për kuvend.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës – kërkoi nga drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit që pas shqyrtimit në kuvend të publikohet në web faqe ky regjistër i shfrytëzuesve të pronave komunale, si dhe regjistri aktual i shfrytëzuesve me qira të objekteve të komunës.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

6. a. Shqyrtimi i Raportit janar-shtator 2018 për të hyrat dhe shpenzimet.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – tha se gjatë periudhës janar-shtator 2018 ka më pak të hyra vetanake, kurse ka më shumë shpenzime, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017.

Sipas tij, tek <administrata dhe personeli> të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 58,763.00 €, kurse në vitin 2017 kemi pasur të hyra të realizuara 36,486.00 €, që do të thotë është pozitive. Për çdo lëvdatë e kemi edhe <Drejtorinë për Buxhet dhe Financa>, ku të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 507,583.52 €, kurse në vitin 2017 kemi pasur të hyra të realizuara 328,563.40 €.

Edhe <Drejtoria për Arsim> është pozitive, pasi që të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 41,862.00 €, kurse në vitin 2017 ka pasur të hyra të realizuara 37,559.25 €. Sipas Klinakut edhe <Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural> është pozitive, pasi që të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 27,624.92 €, kurse në vitin 2017 ka pasur të hyra të realizuara 21,427.00 €. Ndërkaq, <Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë> është më keq, pasi që të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 81,340.00 €, kurse në vitin 2017 ka pasur të hyra të realizuara 100,114.50 €. Tek <Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport>, është më keq në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Pra, të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 1,217.00 €, kurse në vitin 2017 kemi pasur të hyra të realizuara 2,073.00 €.

Klinaku theksoi se <Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit> është shumë keq, pasi që të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 122,417.99 €, kurse në vitin 2017 ka pasur të hyra të realizuara 230,678.95 €. Ai tha se e dimë që kjo drejtori nuk mund t'i detyrojë qytetarët me dhunë me marrë leje ndërtimore. Por, është Drejtoria për Inspektime që mund t'i detyrojë qytetarët që të shkojnë në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të pajisen me leje ndërtimore. Tutje tha se tek <Drejtoria për Shërbime Publike> gjendja është më mirë pasi që të hyrat e realizuara në vitin 2018 janë 133,611.72 €, kurse në vitin 2017 ka pasur të hyra të realizuara 51,614.00 €. Sipas meje, kjo rritje është për shkak se këtë vit ka filluar të bëhet edhe pagesa e mbeturinave, si dhe <gjobat e trafikut> në vitin 2018 janë 110,985.00 €, që do të thotë se janë më të larta në raport me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2017 që kanë qenë 22,155.00€, kurse <gjobat e gjykatave> dhe <të hyrat tjera> janë 740.00€ me 3,7200.00€. Ai pyeti se çka nënkuptojnë <të hyrat tjera>?. Mandej tha se të hyrat vetanake në përgjithësi për këtë nëntëmuor të vitit 2018 janë 1,134,144.89€ kurse në periudhën e njëjtë raportuese për vitin 2017 kemi të hyrat vetanake 1,495,290.86€, që do të thotë se ka më pak të hyra në raport me vitin e kaluar. Ndërkaq, sa u përket shpenzimeve, ai tha se tek kategoria <mallra dhe shërbime> qeveria komunale për këtë periudhë raportuese ka shpenzuar më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit të kaluar. Po ashtu, edhe tek kategoria <shpenzime komunale> qeveria komunale për këtë periudhë raportuese ka shpenzuar më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë

raportuese të vitit të kaluar. Tek kategoria <subvencionet dhe transferet> qeveria komunale për këtë periudhë raportuese ka shpenzuar më pak krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit të kaluar.

Si përfundim, Klinaku theksoi se në vitin 2018 ka 361,145.97€ më pak të hyra vetanake krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Po ashtu, ai tha se edhe shpenzime keni mbi 300 mijë euro më shumë këtë vit, krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese të vitit 2017.

Një arsyetim që e keni dhënë për mua nuk është i arsyeshëm ku thuhet se: “vlen të theksohet se kemi më pak shpenzime se vitin e kaluar në këto kode ekonomike: <furnizimi me ushqim dhe pije>, <karburant për vetura>, <regjistrimi i automjeteve, sigurim i automjeteve, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve>, <drekat zyrtare> etj”. Nga të gjitha këto kode ekonomike, vetëm tek <drekat zyrtare> keni shpenzime më pak dhe për këtë, Klinaku tha se iu përgëzoj, kurse tek çështja e automjeteve, keni pasur mundësi të keni shpenzime më pak, për shkak se keni marrë automjete me qira, por ka ndodh e kundërta, keni shpenzime më shumë, kështu që lidhur me këto çështje që i ngriti, Klinaku kërkoi sqarime.

Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – sqaroi se arsyet që këtë vit kemi më pak të hyra vetanake krahasuar me vitin e kaluar janë: mungesa e pajisjes me leje ndërtimore, shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore, kurse, arsyet pse kemi shpenzime më shumë këtë vit se vitin e kaluar janë: shpenzimet e varrimit dhe pagesa për mbeturina ndaj kompanisë “Uniteti”.

Berat Sadiku, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit - tha se vitin e kaluar në këtë drejtori kanë qenë 706,000.00€ të hyra. Në bazë të kërkesave që i kemi aktualisht, nuk do të mund të arrijmë as gjysmën e këtyre të hyrave për shkak se kemi më pak kërkesa për leje ndërtimore. Prandaj, këto kërkesa që janë do të shqyrtohen në bazë të legjislacionit në fuqi

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri e procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shpallje të ankandit publik.

Islam Latifi, përfaqësues nga Drejtoria për Shërbime Publike – theksoi se këto mjete motorike janë tërësisht të amortizuara dhe se nuk kanë asnjë vlerë për të qëndruar në autoparkun e komunës. Ai deklaroi se deri në kuvend, kësaj liste mund t’i bashkëngjiten edhe mjete tjera motorike.

Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së – theksoi se të shikohen edhe mjetet tjera motorike për t’iu bashkëngjitur kësaj liste, sepse ka edhe vetura tjera që janë të amortizuara dhe se janë vetëm ngarkesë për buxhetin e komunës. Përveç shpenzimeve të mëdha në karburante që bëjnë këto vetura, çdo prishje serioze e tyre që ndodh kushton më shumë sesa me ble atë automjet.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

c. Shqyrtimi i Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019.

Shkëlzen Feka, anëtar i KPF-së – propozoi që në draft-rregullore të parashihen tetë (8) zona, (pra zona e parë dhe e dytë të ndahen dhe të krijohet edhe nga një zonë e re), e jo gjashtë (6) zona sa kanë qenë aktualisht, e që është propozuar në këtë draft.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri procedoi për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës këtë pikë të rendit të ditës.

d. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës pa kompensim, KRM “Uniteti”, Sh.A. njësia në Vushtri.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – sqaroi se Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) “Uniteti” përmes një kërkesë ka kërkuar që t’i jepet në shfrytëzim afatgjatë një parcelë për ta ndërtuar një objekt për nevojat e tyre. Drejtoria pasi që e ka shqyrtuar kërkesën vlerësoi se është në interes të komunës dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës në lokacion afër objektit të ri të ujësjellësit, i cili është një vend i përshtatshëm.

Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së – theksoi se do të ishte mirë që të njoftohemi nga kompania se çka planifikon të ndërtojë në atë pronë, prandaj deri në kuvend është mirë që të njoftohemi për këtë.

Adnan Lahu, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – tha se kompania ka deklaruar se i posedon mjetet financiare për ndërtimin e objektit dhe se sapo të përfundojë çështja e dhënies në shfrytëzim, kompania do të fillojë ndërtimin e objektit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri kërkoi që të plotësohet arsyetimi dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend në mbledhjen e radhës kjo pikë e rendit të ditës.

Rrezarta Krasniqi, anëtare e KPF-së – kërkoi informacione se deri ku ka shkuar propozimi i saj që një shkollë në Vushtri që është pa emër të emërtohet me emrin e “Hajzer Krasniqit”. Pasi siç tha ajo, është kërkesa e dytë që nuk ka marrë përgjigje për këtë.

Mbledhja përfundoi në orën **15:30**.

Bujar Klinaku

Bujar Klinaku
Procesmbajtës



Nasuf Aliu

Nasuf Aliu
Kryesues i KK-së dhe i KPF-së